

Perla shpirtërore

nga Kabiri, Rumi, Mirabai, Ibn Arabi,
Shams Tabrizi dhe Rabia Al Basri

përzgjedhur shqipëruar nga Valdet Fetahu
lektoruar nga Ridvan Bunjaku

janar 2023

Përmbajtja

Rumi	4
ZGJIMI I KRIMBIT	4
EGJIPTI QË NUK EKZISTON	5
PAZARI I FARAVE.....	6
KËNGË PËR NJË GOMAR.....	8
KJO QË E KEMI TANI	11
KUR LUTEMI VETËM.....	12
NËN HAMBAR	13
TRE VËLLEZËR DHE NJË PRINCESHË KINEZE	16
U DASHUROVA ME ENGJËJT.....	23
IKJA NË PYLL	24
SHPORTË ME BUKË TË FRESKËT	25
SHPIRTI DHE TRUPI.....	28
AFËR TË VËRTETËS	29
ÇFARË E LËNDON SHPIRTIN?	30
MIKU I SHPIRTIT	31
SHTËPI MYSAFIRËSH	32
Kabir	33
TRUPI IM ËSHTË PËRMBYTUR	33
TRUPI IM DHE MENDJA IME	34
NGRITE VELLON	35
O MIK, TË DUA, MENDO PËR KËTË.....	36
LUMI DHE VALËT E TIJ JANË NJË.....	37
VETJA E HARRON VETEN	38
ATLETI SHPIRTËROR SHPESH E NDRYSHON NGJYRËN E RROBAVE TË TIJ.....	39
KU PRANVERA, ZOTI I STINËVE, MBRETËRON	40
TË JESH ROB I FORCËS	41
HËNA SHKËLQEN NË TRUPIN TIM.....	42
ZOTI ËSHTË NË MUA.....	43
PIKA DHE DETI.....	44
LLAMPAT NDRIÇOJNË NË ÇDO SHTËPI.....	45
SA I PËRULUR ËSHTË ZOTI?.....	46
S'DO TË VIJ.....	47

Mirabai, Ibn Arabi, Shams Tabrizi, Rabia Al Basri	48
JAM ÇMENDUR.....	48
MË DUAJ. MË DUAJ VEÇ MUA.....	54
40 RREGULLAT E DASHURISË NGA SHAMS TABRIZI	56
FABULA E ËNDRRËS	65
DASHURI.....	66
NË SHPIRTIN TIM	67
REALITETI.....	68
UJI I SHENJTË.....	69
Për botimin	71

Rumi

ZGJIMI I KRIMBIT

Ja si mund njeriu të ndryshojë:
Ekziston një krimb që e ka shprehi
Ta hajë hardhinë e rrushit.
Befas, ai zgjohet.

Quane këtë mëshirë, apo si të doni,
Diçka atë e zgjon, dhe ai më nuk është krimb.
Ai tashmë është hardhi,
por edhe pemishtja gjithashtu, fruta, trungu,
urtësia që rritet dhe lumturia,
të cilat nuk duhen
të gllabërohen.

EGJIPTI QË NUK EKZISTON

Dua t'i them fjalët
që do të flakërojnë derisa i shpreh,
por qëndroj i qetë dhe nuk përpiqem
që të dy botët t'i vendos në një kafshatë.

E mbaj në vete fshehurazi një Egjipt
që nuk ekziston.
A është mirë apo keq kjo gjë? Nuk e di.

Me vite përmes syve e kam shprehur prirjen seksuale.
Më jo.
Nuk jam në asnjë vend më. Nuk di ta emërtoj
atë që e jap. Krejt çfarë dha Shemsi,
mund ta merrni nga unë.

PAZARI I FARAVE

A mund të gjesh pazar si ky?

Në të cilin me një trëndafil
mund të blesh një mijë trëndafila të tjerë?

Në të cilën me një farë
e fiton një kopsht të egër?

Për një frymëmarrje të lodhur
e merr një erë hyjnore?

Pate frikë se mos toka të përpin
dhe era në qiell të të çojë.

Dhe tani fshikëza jote e ujit po të rrjedh
dhe po derdhet në oqeanin nga ku është krijuar.

E ka humbur formën e vet të mëparshme,
por akoma është ujë.
Esenca është e pandryshuar.

Ky dorëzim nuk është pendim,
por respekt i thellë i vetes.

Kur oqeani të afrohet si dashnor,
martohu menjëherë, me nxitim.

Për hir të Zotit!

Në asnjë mënyrë mos e largo!

Jeta nuk ka dhuratë më të çmuar.
Me asnjë gjurmim këmbëngulës
nuk do ta gjesh.

Sokoli i përsosur, pa asnjë arsye,
ka ateruar mbi supet e tua
dhe është bërë i yti.

KËNGË PËR NJË GOMAR

Ajo që vijon të tregon për rreziqet që pasojnë
kur i imiton të tjerët në jetën tënde shpirtërore.
Personalisht takoje Mikun.
Mundohu të shpëtosh nga egoizmi
dhe të depërtosh në një gjendje përtej atyre kufizimeve.
Një sufi endacak mbërriti me një gomar
në një komunitet sufish që ishin shumë të varfër.
Ai e ushqeu gomarin dhe i dha ujë,
e la me shërbëtorin e tij dhe hyri brenda.
Grupi i sufive vendas menjëherë e shitën gomarin
dhe blenë ushqime dhe qirinj për festë.
I gjithë manastiri u pushtua nga admirimi!
U sos durimi dhe tre ditë agjërimi!
Nëse je i pasur dhe i ngopur, mos qesh
me veprime të tilla të pamatura të të varfërve.
Veprimi i tyre nuk doli nga shpirti i tyre,
por u diktua nga nevoja dhe skamja.
Udhëtari iu bashkua festës.
Gjithë kohën i kushtonin vëmendje atij,
e përqaфонin dhe e lavdëronin.
Sema kishte filluar.
Nga kuzhina zgjerohej tymi,
pluhuri ngrihej nga dyshemeja që shkelmohej,
e loja e valltarëve jepte ekstazë.
Ritmikisht shtrinin duart,
me ballë preknin podiumin.
Gjatë është pritur për një mundësi të tillë.
Sufitë gjithmonë duhet të presin një kohë të gjatë
për ta përmbushur një dëshirë. Ja pse janë
grykës aq të mëdhenj.

Por, Sufiu që ushqehet me dritë është tjetërfare,
por të tillë e gjen një në mesin e një mijëve.
Sema vazhdoi rrjedhën e saj dhe përfundoi.
Poeti filloi ta këndojë një këngë shumë të trishtuar:
- "Gomari ka vdekur, biro. Gomarin nuk e ke më."
Të gjithë iu bashkuan këngës, duartrokitnin
dhe këndonin përsëri e përsëri
- "Gomari ka vdekur, biro. Gomarin nuk e ke më."
E sufiu mysafir ishte më i zëshmi në këndim.
Më në fund u gdhi,
dhe ata gjatë u përshëndetën mes vete.
Dhoma e banketit u zbraz.
Burri e nxori jashtë bagazhin dhe thirri shërbëtorin e tij:
"Ku është gomari im?"
"O Zot, gjithçka prej teje!"
"Çfarë do të thotë kjo?"
"Epo, ta kanë shitur gomarin!
Përndryshe nuk do të ishte gjithë kjo festë!"
"Pse nuk u afrove tek unë dhe të ma tregosh këtë?"
"Jam afruar disa herë, por ju gjithë kohës
këndonit zëshëm: "Iku gomari, iku gomari",
kështu që mendova se tashmë e dinit.
Mendova se ju kanë lajmëruar, e ke ndier."
"Qartë.
Imitimi im i gëzimit të tyre çoi deri tek kjo."
Edhe ngazëllimi fisnik i miqve tu në fillim është
vetëm një shkëlqim verbues në ty.
Qëndro me ta derisa ajo ekstazë të të mbushë plotësisht.
Në këtë rast, imitimi buronte nga dëshira
e njeriut për të qenë i pranuar.
Kjo dëshirë edhe e bëri atë të shurdhër ndaj asaj
që përsëritej vazhdimisht.

Mos harro se ka vetëm një arsye
për të bërë çfarëdo qoftë –
takimi me Mikun
është i vetmi shpërblim i vërtetë.

KJO QË E KEMI TANI

Kjo që e kemi tani nuk është fantazi.
Kjo nuk është as pikëllim, as gëzim.

Nuk është as vlerësim,
as ngazëllim as mjerim.

Këto gjëra vijnë dhe shkojnë.
Kjo është një ekzistencë që nuk është e tillë.

Mëngjes është Husam
këtu në shkëlqimin e madh të koraleve,
brenda Mikut, konfirmim i pastër
të asaj që Halaj e botoi.

Çfarë tjetër njerëzit mund të dëshirojnë?

Kur rrushi shndërrohet në verë,
ata e dëshirojnë këtë.

Kur bie shi nga qielli i natës,
në fakt është një tufë lypësish,
dhe të gjithë duan pak nga kjo!

Ajo që jemi tani
e krijoi një trup, qelizë për qelizë,
si bletët që ndërtojnë huall mjalti.

Trupi i njeriut dhe universi
Janë krijuar nga kjo, e jo kjo
nga universi dhe trupi i njeriut.

KUR LUTEMI VETËM

Na sjellin shumë ëmbëlsira dhe rrallë i refuzojmë.
Kur jemi me të tjerët, ulemi me orë të tëra
dhe i shërbejmë Zotit me pasion,
por kur lutemi vetëm, ngrihemi befas pas vetëm pesë minutash.
Vrapojmë poshtë grykës së dëshirave tona.

Por këto veti mund të ndryshojnë,
sikurse mineralet që nga toka depërtojnë në trung
dhe bëhen pemë,
sikurse bima kur takohet me kafshën dhe hyn në të,
ashtu edhe njeriu
mund ta braktisë barrën e rëndë
dhe të bëhet i lehtë.

NËN HAMBAR

Një sufi udhëtoi nëpër botë.
Një natë mbërriti në një komunitet sufi.
E lidhi gomarin në hambar,
pastaj e sollën në krye të podiumit.
Ata hynë në meditim të thellë dhe afërsi mistike,
ai dhe ata shokë.
Për njerëz të tillë
shumë më shumë mund të mësohet nga prania njerëzore
sesa nga libri.
Libri i sufistit nuk u shkrua
Me bojë dhe alfabet.
Njerëzit e ditur i duan gjurmët e lapsit,
dhe jetojnë prej tyre.
Sufitë i duan gjurmët e këmbëve!
Ai i ndjek ata dhe i futet vjedhurazi gjahut.
Në fillim, i shikon tabelat e rrugës.
Pas një kohe, është në gjendje ta ndjekë erën.
Të ecësh i udhëhequr nga aroma është njëqind herë më mirë
sesa t'i përcjellësh gjurmët.
Personi i hapur për hyjnoren për sufistin është si derë hyrëse.
Ajo që të tjerëve mund t'u duket si gur i thjeshtë,
atij i duket diamant.
Ti në pasqyrë qartë e sheh figurën tënde.
Shehu sheh më shumë se kaq, në tullën e hedhur.
Mjeshtrit Sufi janë ata
shpirtrat e të cilëve ekzistonin para krijimit të botës.
Para trupit, ata jetuan shumë jetë.
Para se farat të futeshin në tokë, ata korrnin grurë.
Edhe para formimit të oqeanit, ata i varnin perlat.
Derisa mbahej një kuvend i madh mbi krijimin e qenieve njerëzore,

ata kanë qëndruar deri në mjekra
të fundosur në ujërat e urtësisë.
Derisa disa engjëj e kundërshtonin krijimin e botës,
disa shehë qeshnin dhe duartrokisnin.
Para materialitetit, ata e dinin se si është
të jesh i kapur në kurthin e materies.
Derisa akoma nuk kishte natë, e vështronin Saturnin.
Para se kokrra e gurit të pijej, e shijuan bukën.
Dhe kanë logjikuar pa kurrfarë mendje.
Për ta, intuita e drejtpërdrejtë është
procedura më e thjeshtë e vetëdijes,
ndërsa për të tjerët do të ishte Epifani.
Pjesa më e madhe e mendimit tonë është për të kaluarën,
ose për të ardhmen.
Ata janë të lirë prej tyre.
Para se miniera të gërmohet, ata i ekzaminojnë monedhat.
Para ekzistencës së vreshtave, e parandiejnë dehjen e ardhshme.
Ata e ndiejnë dhjetorin në korrik.
Në mesditën e nxehtë gjejnë hije.
Në gjendjen fani, në të cilën të gjitha gjërat shpërbëhen,
i njohin gjërat.
Qielli i hapur pi nga kupa që qarkullon mes tyre.
Dielli vishet me ar të bujarisë së tyre.
Kur dy prej tyre takohen, nuk janë më dy.
Ata janë një në të gjashtëmijtën.
Valët e oqeanit janë kopja e tyre më besnike,
kur era nga një e krijon një mori.
Kështu i ka ndodhur edhe diellit,
edhe ai përmes dritares u thye në rreze, në trupa.
Disku diellor me të vërtetë ekziston,
por nëse i shikon vetëm rrezet-trupin,
mund ta gjesh veten në dyshim.

Aleanca njeri-hyjni është uniteti.
Shumësi është një ndarje iluzore në rreze.
Mik, ne po udhëtojmë së bashku.
Mohoje lodhjen tënde.
Më lër të të tregoj
një pikë të vogël bukurie që nuk mund të shprehet.
Unë jam si një milingonë që ka arritur në një hambar
kështu, komikisht e lumtur, përpiqet të dalë jashtë
me një kokërr që është shumë e madhe për të.

TRE VËLLEZËR DHE NJË PRINCESHË KINEZE

Dikur ishte një mbret që i kishte tre të djem të njëjtë fisnikë.

Që të tre ishin fisnikë dhe të matur, me vendosmëri të zjarrtë kur ishte e nevojshme.

Qëndronin si tre qirinj me flakë të fuqishme përballë të atit, të gatshëm për ta nisur një udhëtim në zonat e largëta të mbretërisë së tij, që ai të vendosë se a janë të aftë të menaxhojnë drejt dhe me shkathtësi.

Secili prej tyre puthën e dorën e mbretit në shenjë përshëndetje dhe dëgjueshmërie.

“Shkoni ku të doni,” u tha mbreti, “dhe vallëzoni gjatë rrugës.

Të mbrojtur jeni

Vetëm po ju paralajmëroj të mos hyni në një kështjellë që quhet Kalaja që e heq kthjelltësinë.

Në atë kështjellë është një galeri me piktura shumë të bukura që i sjell shumë telashe familjes mbretërore.

I ngjan sallës që Zulejka e dekoroi për ta kapur Jusufin në kurth, kështu që fotografia e saj ishte kudo.

Ai nuk mund t’i shmangej e të mos e shikonte atë. Vetëm atij vendi mos iu afroni.”

Është e kuptueshme, siç ndodh zakonisht,
të tre princat ishin të fiksuar për ta parë atë kështjellë,
edhe përkundër paralajmërimit të babait të tyre, ata kanë hyrë.
Kështjella kishte pesë porta me pamje nga malet
dhe pesë të tjera drejt oqeanit,
si pesë shqisat e jashtme që e sjellin
ngjyrën dhe aromën e dukurive natyrore
dhe pesë shqisat e brendshme që hapen për misteret.

Atje, mijëra piktura nuk u dhanë qetësi princave.
Të dehur, kanë bredhur korridoreve
derisa nuk arritën, që të tre në të njëjtën kohë,
para një portreti të veçantë, para një fytyre femërore.
Pa-shpresshëm ranë në dashuri me të.
“Kjo është ajo për të cilën na ka paralajmëruar babai.
Mendua se ishim mjaft të fortë t'i rezistojmë çdo gjëje,
siç mendon ai që ka etje
se është mjaft i shëndetshëm për të qëndruar,
por tash po e shohim se nuk jemi!
Kush është kjo?”

Një sheik i urtë ua zbuloi fshehtësinë:
“Ajo është një princeshë kineze, dhe ajo e fshehura.
Mbreti kinez e ka fshehur
siç është i mbështjellë shpirti me paramaterie.
Askujt nuk i lejohet të vijë afër saj.
Madje as zogjve nuk u lejohet të fluturojnë mbi kulmin e saj.
Askush nuk mund të zbulojë se si arrihet tek ajo.
Ajo nuk mund të fitohet me përdredhje. Harrojeni këtë gjë!”

Princat, megjithatë, filluan të negociojnë,
si bashkëpunëtorë në të njëjtën lakmi të parezistueshme.

Më i madhi tha:

“Ne kishim vetëbesim me bollëk derisa të tjerëve iu jepnim këshilla,
e na shih tash!

Thoshim: ‘Durimi është çelësi i zgjidhjes’,
por rregullat që i kemi shpikur për të tjerët tani nuk ndihmojnë.
U thoshim të tjerëve: ‘Qeshni!’ E pse jemi kaq të qetë tani?
Ku është forca jonë?”

Të dëshpëruar, u nisën për në Kinë,
jo me ndonjë shpresë të martohen me princeshën,
por vetëm të jenë afër saj.

Ata lanë gjithçka dhe u drejtuan drejt të dashurës së fshehur.
Të maskuar, jetonin në kryeqytet, duke u përpjekur
për ta krijuar një mënyrë për të hyrë në pallatin e saj.

Në fund i madhi tha: “Nuk mund të pres më.
Nuk dua të jetoj nëse më duhet të ndahem nga e dashura.
Për të unë gjithë jetën time e kam rrahur tupanin.

A shqetësohet rosa për mbytjen e anijes?
Këmbët e saj në ujin e oqeanit janë të mjaftueshme lundrim.
Shpirti dhe trupi im janë martuar me këtë objekt krenarie.
Ëndërroj por nuk fle.
Mburrem por nuk gënjej.

Jam qiri.
Le të më godasin edhe njëqind herë në qafë,
prapë shndritshëm do të digjem.
Manteli i jetës sime nga të dyja anët
është djegur.
Le të digjet tërë natën
derisa të mos zhduket.

Më mjafton drita
që hëna e derdh në rrugë.
Do të qëndroj para mbretit
për t'ia thënë kërkesën time”

Vëllezërit u përpoqën ta ndalin, por nuk ia dolën.
Ai brofi në këmbë, dhe duke u përbiruar me vështirësi,
doli para perandorit kinez,
që e ka ditur se çfarë po ndodh, por prapë ka heshtur.
Ai mbret ka qenë brenda tre vëllezërve,
por është shtirë sikur nuk i njeh.
Zjarri nën kazan është iluzion.
Uji i vluar është realitet.

Personi i dashur
është në venat tua,
edhe pse mund të duket se ka formë jashtë teje.

Princi u përkul
dhe ia puthi këmbën mbretit,
dhe mbeti ashtu i përkulur.
“Ky djalosh do të ketë gjithçka që dëshiron,
dhe njëzet herë më shumë se ajo që la pas.
Ai luajti kumar dhe i hodhi rrobat e tij në ekstazë.
Një dashuri e tillë i meriton një mijë kostume.
Ai është lajmëtari i asaj dashurie,
dhe ai është duke e bërë punën e tij shkëlqyeshëm.”

Princi e dëgjoji këtë
dhe nuk mund të fliste,
por shpirti i tij vazhdimisht
fliste me atë shpirt.

Princi mendoj:

‘Kjo është realiteti, ky zgjim, kjo shkrirje’

Për një kohë të gjatë qëndroi me perandorin ashtu i përkulur,
duke u djegur.

‘Vrasja është një gjë,

por ekzekutimi i gjykimit mbi mua po bëhet vazhdimisht,
çdo moment!

I varfër në pasuri,

por i pasur me jetë për sakrifica.

Askush nuk mund ta luajë lojën e dashurisë vetëm me një kokë!’

Kjo pritje e gëzueshme e pushtoi plotësisht.

Pamja e të dashurës u zhduk nga mendja e tij

dhe ai e realizoi unitetin.

‘Kostumi i këtij trupi ishte mëndafsh i këndshëm,

por kjo lakuriqësi është më e këndshme.’

Për këtë gjë më nuk mund të flitet.

Ajo që pason duhet të mbesë fshehtësi.

Njeriu me kalë mbërrin deri te oqeani, por tutje

kali i lashtë i qetësisë mistike duhet ta bartë.

Kur barka fundoset,

ti je peshk, as nuk hesht e as nuk flet, çudi pa emër.

Kështu vdiq vëllai i madh,

dhe vëllai i mesëm erdhi në varrim.

‘Çfarë është tash kjo?

Peshku nga deti i njëjtë!’ mendoj mbreti.

Administratori i pallatit mbretëror lajmëroi –

‘Djali i të njëjtit baba, vëllai i dytë i të ndjerit për nga mosha.’
Mbreti tha: “Po, një dhuratë nga ai që duhet të mbaj mend.”

Një butësi supreme përsëri zbriti,
e oborri dukej i copëtuar si një shegë e qeshur,
dhe të gjitha format e universit fluturuan pranë tendave të tyre,
duke u shfaqur çdo sekondë një krijim i ri.

Ai kishte lexuar për zbulesa të tilla në libra.
E kjo ishte zbulesa e tij. Dhe vetëm përsëriste:
“A ka më? A ka më?”

I ushqyer me qenien e mbretit,
ndjeu kënaqësi më të madhe se kurrë më parë,
e mandej u shfaq krenaria.
‘Po a nuk jam edhe unë mbret, djali i mbretit?
Pse ky sundon mbi mua?
Duhet ta hap edhe unë shitoren time, i pavarur prej tij?’

Mbreti mendoj:
“Unë po të jap dritë të pastër,
e ti po më hedh baltë fytyrës!”

Vëllai i mesëm befas
e kuptoi se çfarë kishte bërë brenda, por ishte vonë.
Shkëlqimi dhe madhështia iu morën.
Nuk ishte më pallua kopshti.
Tani fluturonte si hut i vetmuar nëpër shkretëtirë,
sikurse Ademi që e lëvronte me një ka tokën larg Xhenetit.
E mblodhi veten dhe kërkoi falje,
e pendimit ia bashkoi edhe dhimbjen e thellë
që rrodhi nga humbja e unitetit.

Kjo histori duhet të shkurtohet.
Kur pas një viti doli mbreti nga izolimi.
konstatoi se në kallëpin e tij mungon një shigjetë
dhe se vëllai i mesëm është i vrarë, me fyt të shpuar.

Mbreti qau,
në të njëjtën kohë edhe vrasësi dhe vajtuesi kryesor.
Por prapë, gjithçka ishte ashtu siç duhej.
Vëllai i mesëm gjithashtu i shkoi të dashurës përmes syrit vrasës,
që e ka shkatërruar mendjemadhësinë e tij.

E vëllai i tretë, që ishte i sëmurë deri atëherë,
e fitoi dorën e princeshës.

Ai e kaloi jetën e vet në bashkësi martesore të formës dhe shpirtit,
duke mos bërë asgjë për ta merituar atë.

U DASHUROVA ME ENGJËJT

Tani, betohem në ata burra që nuk gënjejnë.
U dashurova me engjëjt, dhe ata me mua.
Ata ishin të çmendur nga dashuria, po ashtu edhe unë.
Pas kësaj erdha unë dhe ata erdhën me mua.
U zgjova. E pranova dhuratën e Zotit.
E mora prej tyre para se ata ta marrin prej meje.
Shikova në zemrën time, e mësova misterin e Zotit.
I bekuar! I bekuar qofsh! ata sy që më shikonin.
Unë do të kisha vdekur, por Ai e dërgoi mëshirën E Tij.
U ktheva për të ikur, por më pas ata më ndoqën.
Nga frika e Zotit, nuk po them:
Ai shikim i mëkatit më krijoi, më krijoi!
Mos ikni! Në vend të kësaj gjejeni Shemsin në shpirtin tuaj.
Ai na i mbush gotat me verë, na e jep bukën tonë të përditshme.

IKJA NË PYLL

Disa shpirtra janë çliruar nga trupat e tyre.
I shihni? Hapi sytë për t'i parë ata
që ikën për t'u takuar me të ikurit e tjerë,

zemrat e të cilëve shoqërohen në mënyrë të tillë
që ata e kanë braktisur veten e tyre të rreme
për të jetuar në një vete të vërtetë.

Nuk më pengon nëse shokët e mi
largohen për një kohë.

Ata do të kthehen si një i dehur i buzëqeshur.
Të eturit vdesin nga etja.

Bilbili nganjëherë fluturon nga kopshti
për të kënduar në pyll.

Dashuria vjen duke lundruar dhe unë bërtas.
Dashuria qëndron pranë meje si furnizues i vetes.
Dashuria i largon instrumentet
dhe i heq rrobat e mëndafshta.
Lakuriqësia jonë se bashku me ne ndryshoi plotësisht.

SHPORTË ME BUKË TË FRESKËT

Nëse do të mësosh teori,
bisedo me teoricienët.
Kjo mënyrë është me gojë.

Nëse do dervishitet,
varfëri shpirtërore
dhe zbrazëti,
duhet të jesh mik me një mësues.

Të folurit për të, leximi i librave
dhe bërja e ushtrimeve nuk ndihmojnë.
Shpirti e merr atë njohje nga shpirti.

Misteri i mospasjes
Ndoshta jeton në zemrën tënde pelegrin,
dhe prapë njohja e tij ndoshta ende nuk është për ty.

Prite çeltërinë e ndriçuar,
sikur gjoksi të ishte plot dritë.

Mos e kërko jashtë vetes.
Ti je burimi i qumështit.
Mos i mjel të tjerët!

Brenda teje është shatërvani.
Mos ec përreth me kovë bosh.

Ti e ke një kanal në det,
dhe prapë kërkon ujë në një pellg të vogël.

Lutu për zgjerimin e dashurisë.

Medito vetëm në KËTË.

Kurani thotë:

“Ai është me ju, kudoqofshi!”¹

Mbi kokën tënde e ke një shportë me bukë të freskët,
por ti akoma shkon derë më derë duke kërkuar kore.

Trokit në derën e brendshme, askund tjetër,
duke rënë deri në gjunjë në ujërat e freskëta të lumit,
por ti vazhdon të kërkosh nga njerëzit e tjerë qese me ujë.

Uji është kudo rreth teje,
por ti i sheh vetëm barrierat që ta ndalin ujin.

Kali është nën kofshët e kalorësit,
dhe ti akoma pyet: "Ku është kali im?"

Pikërisht aty,
nën ty!

Po, ky është një kalë, por ku është kali?
A nuk po e sheh?

“Po, mund ta shoh, po kush ka parë
kalë të tillë?”

I çmendur nga etja, nuk mund të pish nga burimi
duke vrapuar pranë fytyrës tënde.

Ti je si një perlë në thellësi të detit
duke reflektuar brenda guaskës:

Ku është deti?

¹ 57:4

Këto pyetje mendore
e formojnë barrierën.

Qëndro i hutuar brenda Zotit,
dhe vetëm kaq.

Kur je me të gjithë pos meje
s'je me askë.

Kur nuk je me askë pos meje,
je me të gjithë.

Në vend që të jesh kaq i lidhur me të gjithë,
bëhu të gjithë.

Kur bëhesh aq shumë, je asgjë.
BOSH.

SHPIRTI DHE TRUPI

Mos i ushqe të dy anët e vetes në mënyrë të barabartë.
Shpirti dhe trupi mbajnë ngarkesa të ndryshme
dhe kërkojnë vëmendje të ndryshme.

Shumë shpesh
i vumë shalë Jezusit dhe e lamë gomarin
të vrapojë në kullotë.

Mos e detyro trupin
ta bëjë atë që shpirti e bën më mirë,
dhe mos vë peshë të madhe mbi shpirt
të cilën trupi mund ta bartë lehtë.

AFËR TË VËRTETËS

Si mund t'i njohim cilësitë hyjnore
nga brenda? Nëse i dimë vetëm
përmes metaforave, është si kur

fëmijët pyesin si çka ndjehet seksi
dhe ju përgjigjeni:

"Si karamеле, aq i ëmbël."

Cilësia e seksit

vjen me kënaqësinë brenda vetes.

Çfarëdo që të thoni për misteret,

E di ose nuk e di, të dyja janë

afër të vërtetës. Asnjëra nuk është gënjeshtër.

ÇFARË E LËNDON SHPIRTIN?

Dridhemi, duke menduar se do të shpërndahe mi
në mosekzistencë, por mosekzistenca
frikësohet edhe më shumë se mund t'i jepet forma njerëzore!

Ta duash Zotin është e vetmja kënaqësi. Kënaqësitë e tjera
bëhen të hidhura. Çfarë e lëndon shpirtin?

Të jetosh pa e shijuar ujin e vetë esencës.
Njerëzit fokusohen në vdekje dhe në këtë tokë materiale.
Ata kanë dyshime për ujin e shpirtit.

Këto dyshime mund të pakësohen! Shfrytëzoje natën
për ta zgjuar qartësinë tënde. Errësira dhe uji i gjallë
janë të dashuruar. Lëri të qëndrojnë bashkë.

Kur tregtarët i hanë ushqimet e tyre të mëdha
dhe flenë në gjumin e tyre të vdekur,
hajdutët e natës shkojnë në punë.

Dashuria është rruga e lajmëtarëve
nga misteri na tregojnë gjëra.

Dashuria është nëna. Ne jemi fëmijët e saj.
Ajo shkëlqen brenda nesh, e dukshme – e padukshme,

derisa e humbim besimin ose ndjejmë se ai fillon të rritet përsëri.

MIKU I SHPIRTIT

Dëgjoje thelbin e vetes sate, Mikun.
Kur ndjen mall, ji i durueshëm,
dhe gjithashtu i matur, i moderuar me ngrënien dhe pirjen.

Bëhu si mal në erë.
A e vëreni se si lëviz? Ka të ëmbla
iluzione që vijnë për t'ju joshur.

Bëje një justifikim për to: "Kam problem me tretjen"
ose "Më duhet ta takoj kushëririn tim."

Ti peshkon, grepi i karremit mund të jetë pesëdhjetë
apo edhe gjashtëdhjetë copë ari, por a ia vlen me të vërtetë
liria jote në oqean?

Kur udhëton, qëndro pranë çantës.
Unë jam çanta që e mban atë që ti e do.
A mund të ndahesh nga unë?

Jeto me kujdes në gëzimin e kësaj miqësie.
Mos mendo, por edhe ata të tjerët më duan shumë.

Disa thirrje tingëllojnë si fishkëllima e gjuetarit
për thëllëzën, miqësore, por jo plotësisht
sikur kur e kujton thirrjen e mikut tënd të shpirtit.

SHTËPI MYSAFIRËSH

Kjo genie njerëzore është një shtëpi për mysafirë.
Çdo mëngjes një ardhje e re.

Një gëzim, një depresion, një poshtërsi,
vjen një vetëdije momentale
si një vizitor i papritur.

Të mirëseardhur dhe të gostitur le të jenë të gjithë
Edhe nëse janë një turmë pikëllimesh,
që e fshijnë me dhunë shtëpinë tuaj
bosh nga mobilet e tyre, ende,
trajtoje me nder secilin mysafir.
Ai mund të jetë duke të pastruar
për një kënaqësi të re.

Mendimin e errët, turpin, keqdashjen,
takoji në derë duke qeshur
dhe ftoji brenda.

Ji mirënjohës për këdo që vjen,
sepse secili është dërguar
si udhërrëfyes nga përtej.

Kabir

TRUPI IM ËSHTË PËRMBYTUR

Trupi im është përmbytur
Me flakën e Dashurisë.
Shpirti im jeton në
Furrë lumturie.

Aroma e dashurisë
Ma mbush gojën,
Dhe freski mbi të gjitha gjërat
Me çdo frymënxjerrje.

TRUPI IM DHE MENDJA IME

Trupi im dhe mendja ime janë në depresion sepse
Ti nuk je me mua.

Sa shumë të dua dhe të dëshiroj të jesh në shtëpinë time!
Kur dëgjoj njerëz që më përshkruajnë si nusen tuaj,
shikoj anash i turpëruar,
se e di që thellë brenda nesh nuk jemi takuar kurrë.

Atëherë çfarë është kjo dashuria ime?

Me të vërtetë nuk brengosem për ushqimin,
as gjumi nuk më intereson,
Unë jam i shqetësuar brenda dhe jashtë.
Nusja e do të dashurin e saj aq sa një i etur do ujë.

Dhe si do ta gjej dikë që do ta marrë mesazhin
Për Mysafirin nga unë?
Sa i shqetësuar është Kabiri gjatë gjithë kohës!
Sa shumë dëshiron ta shohë Mysafirin!

NGRITE VELLON

Ngrite vellon
që e fsheh
zemrën

dhe aty
do ta gjesh
atë që je
duke e kërkuar.

O MIK, TË DUA, MENDO PËR KËTË

O mik, të dua,
mendo për këtë mirë
me vëmendje!
Nëse je i dashuruar,
atëherë pse po fle?

Nëse e ke gjetur atë,
jepja veten tënde atij,
merre atë.

Pse po i humb gjurmët e tij
përsëri dhe përsëri?

Nëse përsëri do të biesh në gjumë të rëndë,
Pse të humbësh kohë duke e lëmuar shtratin
dhe duke i rregulluar jastëkët?

Kabiri do t'jua tregojë të vërtetën:
ja si është dashuria:
supozoni se ju është dashur ta prisni kokën tuaj
dhe t'ia jepni dikujt tjetër,
çfarë ndryshimi do të bënte kjo?

LUMI DHE VALËT E TIJ JANË NJË

Lumi dhe valët e tij janë një
zotëri, ku është ndryshimi midis lumit dhe valëve të tij?

Kur vala ngritet,
është ujë;
dhe kur bie,
është po i njëjti ujë.

Më tregoni, zotëri, ku është dallimi?
Veç se është emërtuar valë,
a nuk do të konsiderohet më ujë?

Brenda Brahmës supreme,
botëve u thuhet tespithe:
Shikojeni atë rruzare me sytë e mençurisë.

VETJA E HARRON VETEN

Vetja e harron veten
si qen i tërbuar në tempull me pasqyrë
e leh veten deri në vdekje;
si luan, që e sheh një formë në pus,
dhe kërcen mbi imazhin;
si elefant i eksituar që e fut feçkën
në gur të kristaltë.
Majmuni e ka grushtin e tij të ëmbëlsirave
dhe nuk do ta lëshojë.
Kështu që
nga shtëpia në shtëpi
llomotit.
Kabiri pyet: papagall në shkop
kush të ka kapur?

ATLETI SHPIRTËROR SHPESH E NDRYSHON NGJYRËN E RROBAVE TË TIJ

Atleti shpirtëror shpesh e ndryshon ngjyrën e rrobave të tij,
dhe mendja e tij mbetet gri dhe pa dashuri.

Gjithë ditën qëndron brenda faltores,
kështu që vizitori duhet të dalë jashtë dhe të falet gurëve.

Ose i shpon veshët,
i rrit flokët dhe i mbështjell,
njerëzit e ngatërrojnë me dhinë.
Shkon në vendet e shkreta, i mbyt impulset e tij,
dhe e bën veten as mashkull as femër...

E rruan kokën, e var pelerinën në varëse të portokalltë,
e lexon Bhagavad-Gitën dhe bëhet folës i frikshëm.

Në të vërtetë ju po shkoni në qerre kufomash,
në varreza,
me duar dhe këmbë të lidhura!

KU PRANVERA, ZOTI I STINËVE, MBRETËRON

Ku pranvera, Zoti i stinëve, mbretëron,
Aty Muzika vetvetiu tingëllon E Pagoditur.
Aty rrymat e dritës rrymojnë në të gjitha drejtimet.
Të paktë janë ata njerëz që mund të kalojnë në atë tokë!

Aty ishin miliona Krishnaistë
që qëndronin me duar të palosura,
Ku miliona Vishnuistë e përkulin kokën,
Ku miliona Brahmanistë i lexojnë Vedat,
Ku miliona Indra banojnë në qiell,
Ku gjysmëzotat dhe munitë janë të panumërt,
Ku miliona Saraswatisë, perëndesha të muzikës,
luajnë në veen,
Aty është Zoti im i vetëshpallur:
dhe aroma e sandaleve dhe e luleve qëndron në ato thellësi.

TË JESH ROB I FORCËS

Mik, shpreso për mysafirin sa je gjallë.
Hidhu në përvojë sa je gjallë.
Mendo... dhe vetëm mendo... sa je gjallë.
Atë që ti e quan 'shpëtim' i përket kohës para vdekjes.

Nëse nuk i këput litarët sa je gjallë,
a mendon se
fantazmat do ta bëjnë më pas?

Ideja se shpirti do të bashkohet me ekstazën
Vetëm sepse trupi është kalbur - kjo është e gjitha fantazi.
Ajo që gjendet sot gjendet edhe më pas.
Nëse nuk gjen sot asgjë,
thjesht do të përfundosh në një banesë në Qytetin e Vdekjes.
Nëse sot çon dashuri me hyjninë,
në jetën tjetër do ta kesh fytyrën
e dëshirës së plotësuar.

Kështu që zhytu në të vërtetën,
zbulo se kush është Mësuesi,
Beso në Tingullin e Madh!

Kabiri thotë:

- Kur kërkohet mysafiri, kjo është forcë e lakmisë
për ta gjetur mysafirin që e bën gjithë punën.
Shiko në mua, dhe do ta shohësh robin e asaj force.

HËNA SHKËLQEN NË TRUPIN TIM

Hëna shkëlqen në trupin tim,
Por sytë e mi të verbër nuk mund ta shohin.
Hëna është brenda meje,
dhe dielli gjithashtu.

Daullja e pagoditur e Përjetësisë jehonë brenda meje,
por veshët e mi të shurdhër nuk mund ta dëgjojnë.

Përderisa njeriu bërtet 'Unë' dhe 'E imja',
veprat e tij janë të kota:
Kur e gjithë dashuria për 'Unë' dhe 'E imja' ka vdekur,
atëherë puna e Zotit është kryer.

Sepse puna nuk ka qëllim tjetër veç marrjes së njohurive:
Kur të vijë kjo, atëherë puna hiqet.

Lulja lulëzon për frutat:
kur vjen fruti, lulja thahet.
Era e miskut është në dre,
por ai nuk e kërkon brenda vetes:
bredh në kërkim të barit.

ZOTI ËSHTË NË MUA

Zoti është në mua, dhe Zoti është në ty,
Sikur jeta që është e fshehur në çdo farë.
Kështu që shkatërroje krenarinë tënde, miku im.
Dhe kërkoje Atë brenda vetes.

Kur ulem në zemër të botës Së Tij
Milionat diej flakërojnë nga drita,
Deti i ndezur blu shpërndahet nëpër qiell,
Trazirat e jetës qetësohen,
Të gjitha njollat e vuajtjes shpërlahen.

Dëgjoj kambanat dhe daullet e pagoditura!
Dashuria është këtu; fundosni në ekstazën e saj!
Shirat bien pa ujë,
Lumenjtë janë rrjedha drite.

Si do të mund të shprehem ndonjëherë
Se sa i bekuar ndihem
Të kënaqem me një ekstazë kaq të madhe
Në trupin tim?

Kjo është muzika
Nga takimi i shpirtit me shpirtin,
Nga harresa e të gjitha pikëllimeve
Kjo është muzika
Që i transcendon të gjitha vajtjet e ardhjet.

PIKA DHE DETI

Shkova ta kërkoja Atë
Dhe e humba veten;
Pika u bashkua me detin -
Kush mund ta gjejë tani?
Duke gjurmuar dhe kërkuar se ku është Ai
E humba veten;
Deti u bashkua me pikën -
Kush mund ta gjejë tani?

LLAMPAT NDRIÇOJNË NË ÇDO SHTËPI

Llampat ndriçojnë në çdo shtëpi,
O vetëm i verbëri! dhe ju nuk mund t'i shihni ato.
Një ditë sytë e tu befas do të hapen,
Dhe do të shohësh - se prangat e vdekjes do të bien prej teje.
Aty nuk ka se çfarë të thuhet e as të dëgjohet,
Aty nuk ka se çfarë të bëhet.
Aty është ai i gjalli që është i vdekur,
por që nuk do të vdesë më kurrë.

Sepse ai jeton në vetmi,
prandaj Jogi thotë se shtëpia e tij është larg.

Zoti yt është afër, por ti po ngjitesh në palmë për ta kërkuar Atë.

Prifti Brahman shkon nga shtëpia në shtëpi
dhe i nxit njerëzit në besim:
Mjerisht! burimi i vërtetë i jetës është pranë teje,
e ti ke ngritur një gur për të adhuruar.

Unë kurrë nuk mund të shpreh se sa i ëmbël është Zoti im.
Joga dhe tregimi i rruazave,
virtyti dhe vesi - këto nuk janë asgjë për Të.

SA I PËRULUR ËSHTË ZOTI?

Zoti është lisi në male
që e lejon veten të vdesë
dhe nuk do të mbrohet para atyre me sëpatë,
duke mos dashur t'u shkaktojë turp.
Dhe Zoti është toka që do t'ia lejojë vetes
të deformohet nga veglat e njeriut,
por Ai qan; po, Zoti qan,
por vetëm përballë më të afërmve Të Tij.
Dhe një kafshë e bukur po rrihet për vdekje,
por asgjë nuk mund ta bëjë Zotin
ta thyejë heshtjen E Tij para masës dhe të thotë:
Ndaloni, ju lutem ndaloni, pse po e bëni këtë për mua?
Sa i përulur është Zoti?
Qava – thotë Kabir,
Kur e mësova këtë.

S'DO TË VIJ

S'do të vij
S'do të shkoj
S'do të jetoj
S'do të vdes

Do të vazhdoj ta shqiptoj
Emrin
Dhe ta humb veten
Në të

Jam tas
Dhe jam pjatë
Jam burrë
Dhe jam grua

Jam grejpfrut
Dhe jam limon i ëmbël
Jam hindu
Dhe jam musliman

Jam peshk
Dhe jam rrjetë
Jam peshkatar
Dhe jam koha

Jam asgjë
thotë Kabiri
Nuk jam në mesin e të gjallëve
E as të të vdekurve.

Mirabai, Ibn Arabi, Shams Tabrizi, Rabia Al Basri

JAM ÇMENDUR

Jam çmendur nga dashuria
Dhe askush nuk e kupton gjendjen time.
Vetëm të plagosurit
I kuptojnë vuajtjet e të plagosurve,
Kur zjarri tërbohet në zemër.
Vetëm argjendari e di vlerën e xhevahirit,
Jo ai që e lë të shkojë.
Me dhimbje endem nga dera në derë,
Por askund nuk gjeta mjek.
Thotë Mira: Harken, Mësuesi im,
Dhimbja e Mirës do të qetësohet
Kur Shyam vjen si mjek.

– Mirabai

E shqiptoj Emrin e Lartësuar mbi të shurdhrit dhe të verbrit,
dhe ata shërohen.

E them mbi shpatin shkëmbor të malit,
dhe ai e gris mantelin deri në kërthizë.

Mbi mosekzistencën, edhe ajo fillon të ekzistojë.

Por kur flas me dashamirësi me orë e ditë
me ata që e marrin ngrohtësinë njerëzore
ndaj tallen me te, kur ua përmendi Emrin, nuk ndodh asgjë.

Ata mbeten gur, ose bëhen rërë në të cilën
asnjë bimë nuk mund të rritet.

Sëmundje të tjera janë rrugët
për ardhjen e hirit, por që mospërgjigjja e tyre
çon në blasfemi dhe ftohtësi ndaj Zotit.

Unë nga kjo shpëtoj me ikje.

Shpirti im, mos u mundo të përgjigjesh tani!
Gjeje mikun, dhe fshihu.
Por, çfarë mund të mbetet e fshehur?
Fshehtësia e dashurisë gjithmonë e ngre kokën
dhe i heq të gjitha mbulesat:
"Ja ku jam!"

Mbase, dervishi në meditim bëhet pasqyrë.
Mbreti mund t'i ngulë sytë në fytyrën e tij
dhe ta shohë gjendjen e tij primordiale.
Të bukurve jepu pasqyrë,
dhe lëri të dashurohen në veten.
Në atë mënyrë e lustronjë shpirtin e vet
dhe e zgjojnë kujtesën tek të tjerët.

Besoja plagën tënde mësuesit të kirurgjisë.
Mbi plagë grumbullohen mizat dhe e mbulojnë atë.
Ato miza janë pretendimet tua ndaj asaj
që ti mendon se është e jotja.
Lëre mësuesin t'i largojë ato miza
dhe të vërë ilaç mbi ato plagë.
Mos e kthe kokën. Vazhdo ta vështrosh
plagën e mbështjellur. Përmes saj
drita futen brenda teje.
Dhe për asnjë çast mos mendo
se ti e shëron veten.

Zoti thotë: 'Kë ta duash më shumë se mua, do ta marr nga ti...'

Dhe gjithashtu: 'Mos thuaj: Nuk mund të jetoj pa të

Unë do të kujdesem që ti të mundesh.

Stinët do të ndryshojnë,

do të thahen degët e pemëve që dikur i jepnin hije,

do të mbarojë durimi,

do të largohet dashuria që dikur mendoje se ishte e singertë,

do të jesh i hutuar.

Miku do të kthehet në armik

dhe armiku do të bëhet papritmas mik,

e tillë është bota e çuditshme.

Çdo gjë që mendonit se ishte e pamundur do të jetë e mundur...

"Unë nuk do të rrëzohem", do të thuash dhe do të rrëzohesh,

"Mos bëj gabim" - dhe do të bësh gabime.

Dhe gjëja më e çuditshme në këtë botë është -

"Erdhi fundi" - do thoni ju, por prapë do të jetoni.'

MË DUAJ. MË DUAJ VEÇ MUA

Dëgjo, o i dashur!
Unë jam realiteti i botës, qendra e perimetrit,
Jam pjesë dhe tërësi.
Jam realiteti i vendosur midis Qiellit dhe Tokës,
Kam krijuar perceptim në ty vetëm për të qenë ai
objekt i perceptimit tim.
Nëse pra më percepton mua, e percepton veten.
Por nuk mund të më perceptosh përmes vetes,
Pikërisht përmes syve të mi më sheh mua dhe e sheh veten,
Me sytë e tu nuk mund të më shohësh.
Të kam thirrur aq shpesh dhe nuk më ke dëgjuar
Të jam ekspozuar shumë shpesh por nuk më ke parë.
I kam bërë vetes aromë shumë shpesh, dhe nuk ma ke ndier erën.
Ushqim i shijshëm, dhe nuk më ke shijuar.
Pse nuk mund të më arrish përmes objektit që e prek
Apo të më frymsh përmes parfumeve të ëmbla?
Pse nuk më sheh? Pse nuk më dëgjon?
Për ty lezetet e mija i kalojnë të gjitha të tjerat,
Dhe kënaqësia që ta sjell ty i kalon të gjitha të tjerat.
Për ty jam më i preferuari nga të gjitha gjërat e tjera të mira.
Jam bukuria. Jam mirësia.
Më duaj, më duaj veç mua.
Duaje veten në mua, vetëm në mua.
Ngjite veten tënde në mua,
askush nuk është më i brendshëm se unë,
të tjerët të duan për hir të vetes së tyre.
Unë të dua për veten tënde,
e ti do të largohesh nga ata që janë të dashur.
Ti nuk mund të më trajtosh,
se nëse më afrosh,

kjo është për shkak se unë t'u kam afruar.
Jam më pranë teje se ti vetë,
më pranë se shpirti yt, se fryma jote,
kush nga krijesat do të të trajtonte sikur unë.
Tashmë jam xheloz për ty.
Dua të mos i përkasësh askujt tjetër, madje as vetes
Ji i imi, ji për Mua, siç je në mua
edhe pse nuk je as i vetëdijshëm për këtë.

I dashuri im!
le të shkojmë drejt Bashkimit
dhe nëse e gjejmë rrugën që na çon në ndarje
do ta shkatërrojmë ndarjen.
Le të shkojmë dorë për dorë,
le të hyjmë në prezencën e së vërtetës
le të jetë ajo gjykatësi ynë
dhe ta vulosë përgjithmonë bashkimin tonë

– Ibn Arabi

40 RREGULLAT E DASHURISË NGA SHAMS TABRIZI

1. Ajo se si e shohim Zotin është pasqyrim i drejtpërdrejtë i asaj se si e shohim veten. Nëse Zoti sjell në mendje kryesisht frikë dhe faj, kjo do të thotë se ka shumë frikë dhe faje të rrënjosura brenda nesh. Nëse e shohim Zotin si plot dashuri dhe dhembshuri, të tillë jemi edhe ne.

2. Rruga drejt Të Vërtetës është punë e zemrës, jo e kokës. Bëjeni zemrën tuaj udhërrëfyesin kryesor! Jo mendjen tuaj. Takojeni, sfidojeni dhe në fund mbizotërojeni nefsën tuaj (veten, psikikën, shpirtin) me zemrën tuaj. Njohja e egos suaj do t'ju çojë në njohjen e Zotit.

3. Mund ta studioni Zotin përmes gjithçkaje dhe të gjithëve në univers, sepse Zoti nuk është i mbyllur në një xhami, sinagogë apo kishë. Por nëse ende keni nevojë të dini se ku është saktësisht vendbanimi I Tij, ka vetëm një vend për ta kërkuar atë: në zemrën e një dashuruesi të vërtetë.

4. Intelekti dhe dashuria janë bërë nga materiale të ndryshme. Intelekti i lidh njerëzit në nyje dhe nuk rrezikon asgjë, por dashuria i zgjidh të gjitha hallet dhe rrezikon gjithçka. Intelekti është gjithmonë i kujdesshëm dhe këshillon: "Kujdes nga shumë ekstazë", ndërsa dashuria thotë: "Oh, mos u mërzi! Vetëm noto!" Intelekti nuk thyhet lehtë aty ku dashuria pa mundim mund ta shndërrojë veten në gërmadha. Por thesaret janë të fshehura mes rrënojave. Një zemër e thyer fsheh thesare.

5. Shumica e problemeve të botës rrjedhin nga gabimet gjuhësore dhe keqkuptimet e thjeshta. Kurrë mos i merr fjalët tekstualisht. Kur futesh në zonën e dashurisë, gjuha, siç e dimë, bëhet e papërdorshme. Ajo që nuk mund të shprehet me fjalë mund të kapet vetëm përmes heshtjes.

6. Vetmia e palumtur dhe vetmia e këndshme janë dy gjëra të ndryshme. Kur jeni në vetmi të palumtur, është lehtë ta mashtroni veten duke besuar se jeni në rrugën e duhur. Vetmia e këndshme është më e mirë për ne, pasi do të thotë të jesh vetëm pa u ndjerë i palumtur. Por në fund është më mirë ta gjeni një person që do të jetë pasqyra juaj. Mos harroni: vetëm në zemrën e një personi tjetër mund ta shihni vërtet veten dhe prezencën e Perëndisë brenda jush.

7. Çfarëdo që të ndodhë në jetën tuaj, sado shqetësuese të duken gjërat, mos hyni në lagjen e dëshpërimit. Edhe kur të gjitha dyert mbeten të mbyllura, Zoti do ta hapë një rrugë të re vetëm për ju. Jini mirënjohës! Është e lehtë të jesh mirënjohës kur gjithçka është mirë. Një sufi është mirënjohës jo vetëm për atë që i është dhënë, por edhe për gjithçka që i është mohuar.

8. Durimi nuk do të thotë të durosh në mënyrë pasive. Do të thotë të shikosh në fund të një procesi. Çfarë do të thotë durimi? Do të thotë ta shikosh gjembin dhe ta shohësh trëndafilin, ta shikosh natën dhe ta shohësh agimin. Padurimi do të thotë të jesh shkurtpamës duke mos qenë në gjendje ta shohësh rezultatin. Dashamirëve të Zotit nuk u mungon kurrë durimi, sepse ata e dinë se duhet kohë që gjysmëhëna të bëhet e plotë.

9. Lindja, perëndimi, jugu ose veriu kanë pak ndryshim. Pavarësisht se cili është destinacioni juaj, thjesht sigurohuni që çdo udhëtim ta bëni udhëtim përbrenda. Nëse udhëtoni përbrenda, do të udhëtoni në të gjithë botën dhe më gjerë.

10. Mamia e di se kur nuk ka dhembje, foshnjës nuk i hapet rruga dhe nëna nuk mund të lindë. Po kështu, për ta lindur një vete të re, vështirësitë janë të nevojshme. Siç duhet balta të kalojë nëpër nxehtësi të madhe për t'u bërë e fortë, dashuria mund të përsoset vetëm me dhembje.

11. Kërkimi për dashurinë na ndryshon. Nuk ka asnjë kërkues midis atyre që e kërkojnë dashurinë që nuk është pjekur gjatë rrugës. Në momentin që filloni ta kërkonit dashurinë, filloni të ndryshoni brenda dhe jashtë.

12. Ka më shumë guru dhe mësues të rremë në këtë botë sesa yje në universin e dukshëm. Mos i ngatërroni njerëzit egoistë të drejtuar nga pushteti me mentorët e vërtetë. Një mjeshtër i vërtetë shpirtëror nuk do ta drejtojë vëmendjen tuaj te vetja dhe nuk do të presë nga ju bindje absolute apo admirim të plotë, por përkundrazi do t'ju ndihmojë ta çmoni dhe ta admironi brendësinë tuaj. Zonat e mentorëve të vërtetë janë të tejdukshme si xhami. Ata e lejojnë dritën e Zotit të kalojë përmes tyre.

13. Mundohuni të mos u rezistoni ndryshimeve që ju vijnë. Në vend të kësaj, lëreni jetën të jetojë përmes jush. Dhe mos u shqetësoni se jeta po ju kthehet përmbys. Si e dini se ana me të cilën jeni mësuar është më e mirë se ajo që do të vijë?

14. Zoti është i zënë me përfundimin e punës suaj, si përjashta ashtu edhe përbrenda. Ai është plotësisht i zënë me ju. Çdo qenie njerëzore është një punë në progres që ngadalë por në mënyrë të pashmangshme po shkon drejt përsosmërisë. Secili prej nesh jemi vepër e papërfunduar arti që presim dhe përpiqemi të përfundojmë. Zoti merret me secilin prej nesh veç e veç sepse njerëzimi është art i shkëlqyeshëm i shkathtësisë së shkrimit, ku çdo pikë e vetme është po aq e rëndësishme për tërë figurën.

15. Është e lehtë ta duash një Zot të përsosur, të patëmetë dhe të pagabueshëm që Ai është. Ajo që është shumë më e vështirë është t'i duash qeniet njerëzore me të gjitha papërsosmëritë dhe defektet e tyre. Mbani mend, njeriu mund ta njohë vetëm atë që është në gjendje ta dashurojë. Nuk ka urti pa dashuri. Nëse nuk mësojmë ta duam krijimin e Zotit, nuk mund ta duam dhe as ta njohim vërtet Zotin.

16. Fëlliqësia e vërtetë është ajo brenda. Pjesa tjetër thjesht lahet. Ekziston vetëm një lloj pislleku që nuk mund të pastrohet me ujë të pastër, dhe kjo është njolla e urrejtjes dhe e fanatizmit që e ndot shpirtin. Ju mund ta pastroni trupin tuaj me abstinencë dhe agjërime, por vetëm dashuria do ta pastrojë zemrën tuaj.

17. I gjithë universi është i përfshirë në një qenie të vetme njerëzore – në ty. Gjithçka që ti sheh përreth – përfshirë edhe gjërat që mund të mos të të pëlqejnë, madje edhe njerëzit që i përbuz ose i urren – është e pranishme brenda teje në shkallë të ndryshme. Prandaj, mos e kërko as Shejtanin jashtë vetes. Djalli nuk është forcë e jashtëzakonshme që sulmon nga jashtë. Është zë i zakonshëm përbrenda. Nëse ti vendos ta njohësh veten plotësisht, duke u përballur ndershëm dhe fort.

18. Nëse doni ta ndryshoni mënyrën se si ju trajtojnë të tjerët, së pari duhet ta ndryshoni mënyrën se si e trajtoni veten. Nëse nuk mësoni ta doni veten, plotësisht dhe sinqerisht, nuk ka asnjë mënyrë që të jeni të dashur. Megjithatë, sapo ta arrini atë fazë, jini mirënjohës për çdo gjë që të tjerët mund t'ju hedhin. Është shenjë se së shpejti do të mbuloheni me trëndafila.

19. Mos u shqetëso se ku do të të çojë rruga. Në vend të kësaj, përqendrohu në hapin e parë. Kjo është pjesa më e vështirë dhe për këtë je përgjegjës-e. Pasi ta ndër marrësh atë hap, lër gjithçka të shkojë rrugës së natyrshme dhe pjesa tjetër do të vijojë. Mos shko me rrjedhën. Ji rrjedha.

20. Ne të gjithë u krijuam sipas shëmbëlltyrës Së Tij, e megjithatë secili u krijua i ndryshëm dhe unik. Nuk ka dy njerëz të ngjashëm. Asnjë zemër nuk rrah me të njëjtin ritëm. Nëse Zoti do të kishte dashur që të gjithë të ishin të njëjtë, Ai do ta kishte bërë të tillë. Prandaj, mosrespektimi i dallimeve dhe imponimi i mendimeve tuaja tek të tjerët është një masë e mosrespektimit të planit të shenjtë të Perëndisë.

21. Kur një dashurues i vërtetë i Zotit shkon në tavernë, taverna bëhet dhoma e tij e lutjes, por kur një shishe vere futet në të njëjtën dhomë, ajo bëhet taverna e tij. Në çdo gjë që bëjmë, janë zemrat tona ato që e bëjnë diferencën, jo pamja jonë e jashtme. Sufitë nuk i gjykojnë njerëzit e tjerë se si duken apo kush janë. Kur një sufi e shikon dikë, ai i mban të dy sytë mbyllur dhe në vend të kësaj hap një sy të tretë – syrin që e sheh sferën e brendshme.

22. Jeta është hua e përkohshme dhe kjo botë nuk është gjë tjetër veçse imitim i padetajuar i Realitetit. Vetëm fëmijët do ta ngatërronin një lodër me realitetin. E megjithatë qeniet njerëzore ose magjepsen me lodrën ose me mungesë respekti e thyejnë atë dhe e hedhin mënjanë. Në këtë jetë qëndroni larg nga të gjitha llojet e ekstremiteve, sepse ato do t'ju shkatërrojnë ekuilibrin e brendshëm. Sufitë nuk shkojnë në ekstrem. Një sufi mbetet gjithmonë i butë dhe i moderuar.

23. Njeriu e ka një vend unik midis krijimit të Zotit. "Unë i fryva atij nga Shpirti im", thotë Zoti. Secili prej nesh pa përjashtim është krijuar për të qenë delegat i Zotit në tokë. Pyesni veten, sa shpesh silleni si delegat, nëse e bëni këtë ndonjëherë? Mbani mend, i takon secilit prej nesh ta zbulojmë shpirtin hyjnor brenda dhe të jetojmë sipas tij.

24. Ferri është këtu dhe tani. Kështu është edhe parajsja. Mos u shqetësoni për ferrin ose të ëndërroni për parajsën, pasi të dy janë të pranishëm pikërisht në këtë moment. Sa herë që biem në dashuri, ngjitemi në parajsë. Sa herë që e urrejmë, e kemi zili ose e luftojmë dikë, biem drejt e në zjarret e ferrit.

25. Secili dhe çdo lexues e kupton Kur'anin e Shenjtë në një nivel të ndryshëm të lidhjes me thellësinë e të kuptuarit të tij. Ka katër nivele të njohurive. Niveli i parë është kuptimi i jashtëm dhe është ai me të cilin janë të kënaqur shumica e njerëzve. Tjetri është Batin - niveli i brendshëm. Së treti, ekziston e brendshmja e së brendshmes. Dhe niveli i katërt është aq i thellë sa nuk mund të shprehet me fjalë dhe prandaj është i detyruar të mbetet i papërshtueshëm.

26. Universi është një qenie. Gjithçka dhe të gjithë janë të ndërlidhur përmes një rrjeti të padukshëm të rrëfimeve. Pavarësisht a jemi të vetëdijshëm apo jo, të gjithë jemi në një bisedë të heshtur. Mos bëni dëm. Praktikojeni dhembshurinë. Dhe mos i bëni thashetheme pas shpine askujt – as edhe një vërejtje në dukje të pafajshme! Fjalët që dalin nga goja jonë nuk zhduken, por ruhen përherë në një hapësirë të pafundme dhe do të na kthehen në kohën e duhur. Dhembja e një njeriu do të na lëndojë të gjithëve. Gëzimi i një njeriu do t'i bëjë të gjithë të buzëqeshin.

27. Çfarëdo që të flisni, mirë apo keq, do të kthehet në njëfarë forme tek ju. Prandaj, nëse ka dikush që ushqen mendime të këqija për ju, duke thënë ju gjëra të ngjashme të këqija për të vetëm sa do t'i përkeqësoni gjërat. Do të mbylleni në një rreth vicioz energjie keqdashëse. Në vend të kësaj për dyzet ditë e net thuaj dhe mendo gjëra të mira për atë person. Gjithçka do të jetë ndryshe në fund të 40 ditëve, sepse do të jeni ndryshe brenda.

28. E kaluara është interpretim. E ardhmja është në iluzion. Bota nuk lëviz nëpër kohë sikur të ishte vijë e drejtë, duke vazhduar nga e kaluara në të ardhmen. Në vend të kësaj, koha lëviz nëpër dhe brenda nesh, në spirale të pafundme. Përherësia nuk do të thotë kohë e pafund, por thjesht pakohësi. Nëse dëshironi ta përjetoni ndriçimin e përjetshëm, hiqeni nga mendja juaj të kaluarën dhe të ardhmen dhe qëndroni brenda momentit të tashëm.

29. Fati nuk do të thotë se jeta juaj ka qenë e paracaktuar rreptësisht. Prandaj, të jetosh gjithçka sipas fatit dhe të mos kontribuosh aktivisht në muzikën e universit është shenjë e injorancës së plotë. Muzikaliteti në univers është i përhapur dhe është i kompozuar në 40 nivele të ndryshme. Fati juaj është niveli ku e luani melodinë tuaj. Mund të mos e ndryshoni instrumentin tuaj, por se sa mirë luani është plotësisht në duart tuaja.

30. Sufiu i vërtetë është i tillë që edhe kur akuzohet, sulmohet dhe dënohet pa të drejtë nga të gjitha anët, qëndron me durim, duke mos e shqiptuar asnjë fjalë të keqe për asnjërin prej kritikëve të tij. Një sufi nuk e ndan kurrë fajin. Si mund të ketë kundërshtarë apo rivalë apo edhe “të tjerë” kur nuk ka “unë” në radhë të parë? Si mund të fajësohet dikush kur është vetëm Një?

31. Nëse doni ta forconi besimin tuaj, do t'ju duhet të zbuteni brenda. Që besimi juaj të jetë i fortë, zemra juaj duhet të jetë e butë si pendë. Përmes një sëmundjeje, aksidenti, humbjeje apo frike, në një mënyrë apo tjetër, të gjithë përballemi me incidente që na mësojnë se si të bëhemi më pak egoistë e gjykues dhe më të dhembshur e bujarë. Megjithatë, disa prej nesh e mësojnë mësimin dhe arrijnë të bëhen më të butë, ndërsa disa të tjerë përfundojnë duke u bërë edhe më të ashpër se më parë...

32. Asgjë nuk duhet të qëndrojë mes jush dhe Zotit. As imamë, priftërinj, rabinë apo rojtarë të tjerë të udhëheqjes morale apo fetare. As mjeshtra shpirtërorë dhe madje as besimi juaj. Besoni në vlerat dhe rregullat tuaja, por kurrë mos i impononi ato mbi të tjerët. Nëse vazhdoni t'i thyeni zemrat e njerëzve të tjerë, çfarëdo detyre fetare që e bëni nuk është e mirë. Qëndroni larg çdo lloj idhujtarie, sepse ato do t'ju turbullojnë shikimin. Zoti dhe vetëm Zoti le të jetë udhërrëfyesi juaj. Mësoje Të Vërtetën, miku im, por ki kujdes të mos bësh fetish nga të vërtetat e tua.

33. Derisa të gjithë në këtë botë përpiqen të arrijnë diku dhe të bëhen dikush, vetëm për t'i lënë të gjitha pas vdekjes, ti synoje fazën supreme të hiçit. Jetoje këtë jetë shumë lehtë dhe bosh si numri zero. Ne nuk jemi ndryshe nga një tenxhere. Nuk janë dekorimet e jashtme, por zbrazëtia e brendshme ajo që na mban drejt. Po kështu, nuk është ajo që ne aspirojmë të arrijmë, por vetëdija e hiçit që na mban në përparim.

34. Nënshtrimi nuk do të thotë të jesh i dobët apo pasiv. Nuk çon në fatalizëm dhe as në kapitullim. Pikërisht e kundërta. Fuqia e vërtetë qëndron në nënshtrimin ndaj një fuqie që vjen nga brenda. Ata që i nënshtrohen esencës hyjnore të jetës do të jetojnë në qetësi dhe paqe të patrazuar, edhe kur e gjithë bota kalon nëpër turbulencë pas turbulence.

35. Në këtë botë, nuk janë ngjashmëritë apo rregullat që na çojnë një hap përpara, por të kundërtat e prera. Dhe të gjitha të kundërtat në univers janë të pranishme brenda secilit prej nesh. Prandaj besimtari duhet ta takojë jobesimtarin që banon brenda. Dhe jobesimtari duhet t'i njohë besimtarët e heshtur në të. Deri në ditën kur njeriu arrin në fazën e Insan-I Kamilit, qenies njerëzore të përsosur, besimi është proces gradual dhe që e kërkon atë që në dukje është e kundërta e tij: mosbesimin.

36. Kjo botë është ngritur mbi parimin e reciprocitetit. As një pikë e mirësisë dhe as një grimcë e të keqes nuk do të mbeten pa u kthyer. As komplotet, mashtrimet apo truket e njerëzve të tjerë. Nëse dikush po e ngre një kurth, mbani mend, edhe Zoti po e ngre një kurth. Ai është planifikuesi i fshehtë më i madh. As edhe një gjethe nuk lëviz jashtë dijes së Zotit. Thjesht dhe plotësisht besoni në këtë. Çkado që bën Zoti, e bën bukur.

37. Zoti është bërës i përpiktë i orës. Aq i saktë është urdhri i Tij sa çdo gjë në tokë ndodh në kohën e vet. As një minutë më vonë dhe as një minutë më herët. Dhe për të gjithë pa përjashtim, ora funksionon me saktësi. Për secilin ka një kohë për të dashuruar dhe një kohë për të vdekur.

38. Nuk është kurrë vonë për ta pyetur veten: “A jam gati ta ndryshoj jetën që po e jetoj? A jam gati të ndryshoj përbrenda?” Edhe nëse një ditë e vetme në jetën tuaj është e njëjtë me një ditë më parë, sigurisht që është për të ardhur keq. Në çdo moment dhe me çdo frymëmarrje të re, njeriu duhet të përtërihet dhe të ripërtërihet. Ka vetëm një mënyrë për të lindur në një jetë të re: të vdesësh para vdekjes.

39. Derisa pjesa ndryshon, tërësia mbetet gjithmonë e njëjtë. Për çdo hajdut që largohet nga kjo botë, lind një i ri. Dhe çdo person i denjë që ndërron jetë zëvendësohet nga një i ri. Në këtë mënyrë jo vetëm që asgjë nuk mbetet e njëjtë, por edhe asgjë nuk ndryshon në të vërtetë. Për çdo sufi që vdes, një tjetër lind diku.

40. Një jetë pa dashuri nuk vlen. Mos e pyesni veten se çfarë lloj dashurie duhet të kërkon, shpirtërore apo materiale, hyjnore apo të zakonshme, lindore apo perëndimore. Ndarjet çojnë vetëm në më shumë ndarje. Dashuria nuk ka etiketa, nuk ka përkufizime. Është ajo që është, e pastër dhe e thjeshtë. Dashuria është uji i jetës. Dhe një dashurues është shpirt zjarri! Universi kthehet ndryshe kur zjarri e do ujin.

Ironike, por një nga aktet më intime
të trupit tonë është
vdekja.

Aq e bukur dukej vdekja ime – duke e ditur se kë do ta puthja,
Kam vdekur një mijë herë para se të vdisja.

Vdis para se të vdesësh; tha Profeti
Muhamed.

A keni krahë që u frikësuan ndonjëherë
ta prekin diellin?

Unë kam lindur kur nga çdo gjë
që frikësohesha – e dashuroja.

"O Zot, nëse të adhuroj Ty nga frika e ferrit,
atëherë më djeg në ferr.

Nëse të adhuroj Ty sepse e dëshiroj Parajsën,
atëherë më përjashto nga Parajsa;

Por nëse të adhuroj Ty vetëm për Vetën tënde,
atëherë mos ma moho Bukurinë Tënde Të Përjetshme"

– Rabia Al Basri

FABULA E ËNDRRËS

E pashë veten në një kopsht të gjerë e të gjelbër, më të bukur se sa do të mund ta imagjinoja. Në këtë kopsht ishte një vajzë e re. I thashë:

– Sa i mrekullueshëm qenka ky vend!’

– A do të dëshiroje ta shihje një vend edhe më të bukur se ky? – pyeti ajo.

– Oh po! – u përgjigja.

Më pas, duke më marrë për dore, më çoi deri sa nuk arritëm te një pallat i mrekullueshëm, të tillë që nuk ishte parë ndonjëherë nga sytë e njeriut. Vajza e re trokiti në derë dhe dikush e hapi atë. Përnjëherë të dyjat u përmytëm me dritë.

Vetëm Zoti e di kuptimin e brendshëm të vajzave që pamë të jetonin atje. Secila nga ato e mbante në dorë një tepsi të mbushur me dritë. Vajza e re i pyeti vajzat se ku po shkonin, dhe ato iu përgjigjën:

– Po e kërkojmë dikë që u mbyt në det dhe kështu u bë dëshmore. Ajo nuk ka fjetur kurrë natën, as edhe një sy gjumë! Do të hedhim erëza funerali në trupin e saj.

– Atëherë lyejeni trupin e mikes sime që është këtu – tha vajza e re.

– Prej kohësh – thanë vajzat – një pjesë e këtyre erëzave dhe aroma e tyre i janë ngjitur kësaj vajze në trup, por më pas ajo u largua.’

Me shpejtësi vajza ma lëshoi dorën, u kthye dhe më tha:

“Lutjet tuaja janë drita jote;

Devotshmëria jote është forca jote;

Gjumi është armiku i të dyjave.

Jeta jote është e vetmja mundësi që jeta mund të ta japë.

Nëse e injoron, nëse e shpenzon kot,

Do të shndërrohesh në pluhur”.

Më pas vajza e re u zhduk.

DASHURI

Të kam dashur Ty me dy dashuri –
një dashuri egoiste dhe një dashuri që është e denjë për Ty.
Sa i përket dashurisë egoiste,
aty e pushtoj veten me Ty,
duke i larguar të gjitha të tjerat.
Por në dashurinë që është e denjë për Ty,
Ti e ngre velin që unë të kem mundësinë të të shoh Ty.
Megjithatë lâvdi nuk është i imi për këtë apo atë,
lâvdi të përket Ty edhe për këtë edhe për atë.

– Rabia Al Basri

NË SHPIRTIN TIM

Në
shpirtin tim
ka një tempull, një faltore, një xhami, një kishë
ku gjunjëzohem.

Lutja duhet të na çojë në një altar ku nuk ka mure apo emra.

A nuk ka një religjion dashurie ku forca supreme
e ndriçon hiçësinë,

ku ekstaza derdhet në vetvete
dhe bëhet
e humbur,

ku krahu është plotësisht i gjallë
por nuk ka mendje e as
trup?

Në
shpirtin tim
ka një tempull, një faltore, një xhami, një kishë

që prishen,
që treten në

Zot

REALITETI

Në dashuri, asgjë nuk ekziston mes zemrës dhe zemrës.

Fjala lind nga malli.

Përshkrimi i vërtetë nga shija e vërtetë.

Ai që e ka shijuar, e di –

se ai që shpjegon, gënjen.

Si mund ta përshkruani formën e vërtetë të Diçkasë

Në prezencë të të cilës jeni fshirë?

Dhe në qenien e Të Cilës ekzistoni akoma?

Dhe kush jeton brenda jush si gjurmë për udhëtimin tuaj?

UJI I SHENJTË

Askush nuk jeton jashtë mureve të këtij vendi të shenjtë, ekzistencës.
Uji i shenjtë, më duhet në sytë e mi:
je Ti Ai, i dashur, Ti – në çdo formë.

Cila nënë do të humbiste foshnjën e saj - edhe ne jemi të tillë për Zotin,
Kurrë nuk kemi humbur nga vështrimi i Tij
Çdo britmë e zemrës
ndiqet nga krahët e vetë dritës.

Dallimet ekzistojnë, por jo në qytetin e dashurisë.
Kështu që, betimet e mia dhe Tuat, e di që janë të njëjta.

Sapo e kam qëruar lëkurën nga patatja
dhe ti ende po e mendon vlerën e saj, i dashur;
me të vërtetë ka lëndë ushqyese të mrekullueshme në të gjitha,
sepse Zoti krijoi gjithçka.

Ju u bashkuat me komunitetin tonë që në lindje.
Meqenëse Ati juaj është Ai që është,
që i bëri peshoret e botës ta dinë vlerën tuaj të çmuar.
Prifti dhe prostituta - peshojnë njësoj
para Birit pa-mëkate,
Po kush mund ta durojë këtë të vërtetë dhe liri,
kështu që një njeri i mençur i falsifikoi
shkrimet e shenjta;
këtë çdo njeri i mençur e di.

Fytyra e shpirtit tim ma ka zbuluar bukurinë e saj;
pse ishte kaq gjatë e turpshme,
a nuk e dinte se si kjo më bëri të vuaj dhe të qaj?

Një lojë ndryshe Ai luan me të afërmit e Tij.
Zoti na thotë të vërtetat që nuk do ta besoni,
sepse shumica kryesisht kanë nevojë të kufizuar
të dhembshurisë së Tij;
konceptet 'e drejta' dhe 'e gabuara' e ruajnë farën e artë
derisa mos të vijë një nga miqtë e Perëndisë
dhe të kujdeset për trupin tuaj si nuse hyjnore.

I Shenjti e dërgoi një topograf
për t'i gjetur kufijtë e dhembshurisë dhe ekzistimit të tij.
Zoti e di frustrimin hyjnor sa herë që vepron kështu,
sepse Pafundësia nuk ka mure.

Pse të mos e ngacmoni Atë për këtë?
Pse të mos e pranoni lirinë e asaj që thotë
se Zoti ynë na sheh si Vetën E Tij.

Aq i madhërishëm është sovraniteti i Dashuruesit tonë,
kurrë mos thuaj:
"Në anën tjetër të këtij lumi sundon një Mbret tjetër."
Se si mund të jetë e vërtetë kjo –
kur asgjë nuk mund ta kundërshtojë forcën e Pafundësisë.

Askush nuk jeton jashtë mureve të këtij vendi të shenjtë, ekzistencës.

Uji i shenjtë për të cilin ka nevojë balli i shpirtit tim është uniteti.
Dashuria ma hapi syrin
dhe e pastroi nga dëlirësia e secilës
formë.

– Rabia Al Basri

Për botimin

Online

<https://www.facebook.com/forcajohese/>

<https://botimetr.b.wordpress.com/>

<https://sa-kra.ch/>

Licensimi

Ky publikim lëshohet nën licensën



Attribution-NonCommercial-ShareAlike

CC BY-NC-SA

This license lets others remix, tweak, and build upon your work non-commercially, as long as they credit you and license their new creations under the identical terms.

që nënkupton se i lejon të tjerët ta shkarkojnë dhe ta shpërndajnë te të tjerët, ta ndryshojnë punën në mënyrë jokomerciale, përderisa e përmendin burimin dhe i licencojnë krijimet e reja nën terma identike. Për më tepër, shih:

<http://creativecommons.org/licenses/>